Aleanca kërkon pension kontributdhënës edhe për ata që s'kanë 15 vjet stazh



Faqe 2

Pasuri prej 8 miliardë eurosh në mbetjet e Trepçës



Faqe 4

Rubio i cilëson produktive bisedimet mes Rusisë dhe Ukrainës



Faqe 6

Hajrizi e Fazliji kërkojnë fitore ndaj Izraelit



Faqe 17

KOHA DITORE

e mërkurë • 11 nëntor 2026

Numri 10543

www.koha.net

KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI, KA MARRË PJESË NË FORUMIN E PAQES NË PARIS

Kurti pret nga qeveria e re e Serbisë që ta njohë pavarësinë e Kosovës

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se për normalizim të marrëdhënieve me Serbinë, kërkohet njohja e Kosovës nga ky shtet. Gjatë pjesëmarrjes në Forumin e Paqes në Paris, ai ka shprehur pritjen që këtë ta bëjë qeveria e re në Beograd, që do të dalë pas zgjedhjeve të 25 tetorit

Rrezon Gashi

PRISHTINË, 10 TETOR - Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë duhet të nisë me dorëzimin e Milan Radoiçiqit, ka thënë të martën, kryeministri Albin Kurti në një diskutim me studentë të Shkollës së Parisit për Çështje Ndërkombëtare.

Gjatë vizitës në Francë, në kuadër të Forumit të Paqes në Paris, Kurti ka thënë se qeveria e re e Serbisë, e dalë pas zgjedhjeve të 25 tetorit, duhet ta njohë Kosovën si shtet.

"Ky duhet të jetë gjithashtu një proces përmes të cilit qeveria e Serbisë, e cila së fundmi ka kaluar nëpër një ndryshim të udhëheqjes, të arrijë ta njohë realitetin e shekullit XXI: Kosova është shtet i pavarur, i njohur nga mbi 120 shtete. Dhe Serbia duhet ta braktisë fushatën e saj agresive kundër njohjes sonë ndërkombëtare", ka thënë ai.

E gjatë pjesëmarrjes në një tjetër panel, Kurti është pyetur nëse ndihma e shtetit për apelimin e vendimit dënues ndaj katër ish-krerëve të UÇK-së përbën ndërhyrje të politikës në drejtësi.

Ai ka thënë se mbështetja e ekipeve mbrojtëse nuk bie ndesh me parimin e ligjit mbi politikën.

"Nëse nuk jeni të kënaqur me verdiktin, bëji të gjitha punët e nevojshme për apelim dhe kurrë mos u ndal të besosh në të vërtetën dhe të punosh për drejtësinë", ka thënë ai. Paneli i titulluar "Krijimi i paqes që qëndron dhe rindërtimi i shoqërive pas luftës", është moderuar nga Tatiana Carayanis, këshilltare për çështje globale dhe teknologji në Institutin për Studime të Avancuara.

Krahas Kurtit, në panel ka marrë pjesë edhe Carlo Monticelli, guvernator në Bankën Zhvillimore të Këshillit të Evropës.

Kurti në këtë diskutim ka dhënë këshilla edhe për Sirinë e Ukrainën. Ai ka theksuar se gjatë procesit të rindërtimit pas luftës, shtetet nuk duhet ta shkëmbejnë demokracinë për zhvillimin, por duhet t'i mbajnë të dyja.

Po ashtu ka folur edhe për rëndësinë e arsimit dhe shëndetësisë, si parakushte që investimet në infrastrukturë të përkthehen në zhvillim.

Por, në Kosovë, këto fusha vazhdojnë të përballen me sfida.

Gjatë qeverisjes 6-vjeçare të Kurtit, nxënësit kosovarë kanë shënuar rezultate të dobëta në testin PISA dhe nuk është shënuar progres nga viti në vit. Në shëndetësi, ndonëse është rritur buxheti, pacientët përballen me mungesë të medikamenteve të listës së barnave esenciale, e Raporti i Progresit për vitin 2026 ka evidentuar se 40% të shpenzimeve shëndetësore paguhen nga vetë pacientët.

E sa u përket investimeve kapitale, kategori që përfshin infrastrukturën, nga të dhënat e Ministrisë së Financave rezulton se nga janari 2026 deri në shtator, Qeveria ka shpenzuar vetëm 30% të buxhetit për këtë kategori të shpenzimeve.



Paris, 10 nëntor - Normalizimi i marrëdhënieve me Serbinë duhet të nisë me dorëzimin e Milan Radoiçiqit, ka thënë të martën kryeministri Albin Kurti në një diskutim me studentë të Shkollës së Parisit për Çështje Ndërkombëtare. Gjatë vizitës në Francë, në kuadër të Forumit të Paqes në Paris, Kurti ka thënë se qeveria e re e Serbisë, e dalë pas zgjedhjeve të 25 tetorit, duhet ta njohë Kosovën si shtet

VAZHDOJNË PROCESI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTKODIN CIVIL

Qytetarët kundërshtojnë bashkësinë civile mes sekseve të njëjta

Valbona Bytyqi

Prishtinë, 10 nëntor - Mbi 140 qytetarë, deri të martën, kanë kundërshtuar lejimin e bashkësisë civile për personat me seks të njëjtë, të paraparë në projektkodin civil.

Gjatë procesit të konsultimit publik, që do të përmbyllet më 16 nëntor, dhjetëra qytetarë kanë paraqitur komentet për fushat që rregullon ky dokument.

Nga komentet, që janë publike në platformën e konsultimeve publike, fokusi prej qytetarëve është vënë te neni 1138.

"Nuk mund të pajtohem me përpjekjet për të ndryshuar kuptimin tradicional të martesës, familjes dhe gjinisë përmes legjislacionit. Ligjet e një shteti nuk duhet të miratohen duke shpërfillur bindjet, vlerat dhe shqetësimet e një pjese të konsiderueshme të qytetarëve të tij", ka shkruar qytetari P. Kajtazaj.

Një qytetar tjetër ka aluduar se me lejimin e bashkësisë civile është duke u munduar t'u shkohet për shtati politikave ndërkombëtare.

"Duhet të kemi respekt për veten si popull, e si shtet, e pastaj edhe të tjerët do të na respektojnë për vlerat që po i mbajmë. Gjithashtu, shtetet e tjera që i kanë përkrahur ato që thuhen në këto nene, veçse po tërhiqen prej tyre duke e parë qartë se janë të dëmshme për shoqërinë", ka shkruar Q. Fondaj.

Sipas disa prej qytetarëve, neni që lejon bashkësinë civile mes sekseve të njëjta "bie ndesh me vlerat tradicionale, kulturore dhe familjare të shoqërisë sonë".

"Ne nuk pranojmë që këto vlera të relativizohen apo të zëvendësohen në emër të modernizimit dhe prirjeve të kohës", ka shkruar B. Vishi.

Kundërshtime janë shprehur edhe nga shoqëria civile.

Organizata "CEL Kosova" ka kërkuar që Kodi Civil ta njohë dhe ta rregullojë të drejtën në martesë për çiftet e seksit të njëjtë.

"Që të largohet gjuha përjashtuese në bazë të orientimit seksual përgjatë draftkodit civil ashtu që kudo që përmendet togfjalëshi "një burrë dhe një grua" të zëvendësohet me 'dy persona', ose përshtatshmërisht 'bashkëshort/e'", ka shkruar CEL Kosova.

Përveç bashkësisë civile, qytetarët kanë adresuar kritika edhe për nenet e ProjektKodit Civil që prekin adaptimin e fëmijëve e atësinë e atyre me fekondim të asistuar.

"Adoptimi është e drejtë e fëmijës, jo e të rriturve. Interesi më i mirë i fëmijës përmbushet më së miri në një familje me nënë dhe baba. Kërkojmë gjithashtu harmonizimin e Kodit me ligjin për fekondimin e asistuar mjekësisht, në mënyrë që ky trajtim të jetë i qasshëm vetëm për bashkëshortët me certifikatë martese. Pa këtë, Neni 1138(4) mund të hapë rrugën që në certifikatën e lindjes të shënohen dy nëna", ka shkruar qytetari L. Zaraj.

Neni që lejon bashkësinë civile mes sekseve të njëjta, u pat bërë shkaku që projektkodi civil nuk arriti të miratohet në Kuvend, katër vjet më parë. Këtë vit, mosmiratimi eventual i tij, do t'i kushtojë Kosovës mbi 9.3 milionë euro, të parapara në kuadër të Planit të Rritjes të Bashkimit Evropian.

Teatri i Operës dhe Baletit pa projekt në vitin e "nisjes së punimeve"



Zotimet qeveritare se më 2026 do të nisë ndërtimi i projektit më të madh të infrastrukturës kulturore që synon shteti, kanë mbetur vetëm fjalë. Madje, as projekti zbatues nuk është gati. Fiks 21 muaj pasi është prezantuar projekti ideor për Teatrin e Operës dhe Baletit, janë shpalosur renderët e radhës. Kësaj here, në zyrën...

Faqe 12